



Datë: 10.06.2025  
Numër Protokolli: 4034/2025

A.nr.550/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.550/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesi L.B, kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 10.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa më numër A.nr.550/2025, e datës 25.03.2025, e parashtruar nga ankuesi L.B.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil L.B (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 25.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimi të datës 04.03.2025, të Kryetarit të Komunës së Ferizajt mbi refuzimin e kërkesës për lidhjen e marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura nga Komuna e Ferizajt.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3103/2025 të datës 12.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1986/2025 të datës 25.03.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit me nr.01-317/2024 të datës 27.05.2024, Formularin e përshkrimit të punës të 31.05.2024, vendimin 01.Nr.318/2022 të datës 14.02.2022 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit

të drejtpërdrejt të menaxherit kontratës, vendimin 01. Nr. 308/2023 të datës 16.10.2023 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherit kontratës, vendimin Nr. 01-190/2024 të datës 01.07.2024 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave, kërkesën e datës 05.02.2025 të ankuesit drejtuar Kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe njoftimi i datës 04.03.2025, i Kryetarit të Komunës së Ferizajt mbi refuzimin e kërkesës për lidhjen e marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 31.05.2024 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Shërbime me Qytetar në Sektorin për Shërbime me Qytetar në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Ferizajt.

Tutje sipas shkresave të lëndës, rrjedh se ankuesi më datë 05.02.2025, i është drejtuar më kërkesë Kryetarit të Komunës së Ferizajt për lidhje të marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar.

Meqenëse ankuesit iu ka refuzuar kërkesa e tij nga Kryetari i Komunës së Ferizajt me arsyetimin e mungesës së mjeteve për të realizuar kërkesën e tij, i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën ka kërkuar aprovimin e ankesës së tij.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 04.03.2025, të Kryetarit të Komunës së Ferizajt mbi refuzimin e kërkesës për lidhjen e marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar, pretendon se sipas vendimit 01.Nr. 318/2022 të datës 14.02.2022 për emërimin e menaxherit të kontratës, vendimin 01. Nr. 308/2023 të datës 16.10.2023 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe vendimin Nr. 01-190/2024 të datës 01.07.2024 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave të caktuar si anëtarë i komisionit, i takon e drejta për kompensim për punë me vëllim të shtuar.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankueses, të ndërlidhura me provat materiale, ju referuar Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht:

Nenit 13, i cili përcakton: *Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji.*

Nenit 22 paragrafi 1, i cili përcakton: *1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale.*

Nenit 28 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, ku përcaktohet: *1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që*

*tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar.*

Ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, gjegjësisht me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2, përcaktohet: 1. Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Shtesa për vëllimin e punës përfitohet nga nëpunësit civil, për punën e kryer për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, ndërsa me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje përcaktohet: 1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njësisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit.

Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesa e ankuesit për realizimin e kompensimit për punë me vëllim të shtuar si menaxher i kontratës dhe anëtarë i komisionit për vlerësimin e ofertave, nuk bie në këtë kategori të kompensimeve siç është përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, mirëpo funksionet të cilat në bazë të vendimeve ushtron ankuesi janë funksionin shtesë të cilat zyrtari ushtron krahas pozitës aktuale që mbanë. Statusi i kërkesës së ankuesit është e rregulluar me nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Ku neni 38 i Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik ka përcaktuar: 1. Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.

Në zbatim të këtij nëmni Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë e cila në nenin 5 ka paraparë kriteret për përfitimin e kompensimit për funksion shtesë si në vijim: *1. Nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur. 2. Përjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar.*

Me qëllim të zbatimit sa më të drejtë të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar Qarkoren rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë me nr. 356/20232 të datës 21/03/2023, ku ndër tjera kjo qarkore ka specifikuar në pikën 5 të saj se: *Kompensimi nuk u takon zyrtarëve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga pozita që mbajnë, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe /apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. Një zyrtar nuk mund të kompensohet për pjesëmarrje në Komisione të tilla si: Komision Disiplinor, Komision i Brendshëm i Ankesave ( për institucione që kanë të tilla); **Komisione për Vlerësim**, Komisione për Rekrutim, Komisione për Shit/Blerjen e Banesave, **Komisione që lidhen me procedura te Prokurimit**, Komisione/Grupe Negociuese dhe komisione/borde të ngjashme.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, ndërsa Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, ka hyrë në fuqi më datë 06.02.2023, dhe duke marr parasysh periudhën kohore për të cilën ankuesi pretendon se ka kryer funksione shtesë gjegjësisht nga data 14.02.2022 sipas vendimit 01.Nr. 318/2022 të datës 14.02.2022, Kolegji vlerëson se shtesa të kërkuar nuk mund të aplikohen për një periudhë me të cilën nuk ka qenë e parashikuar një shtesë e tillë, po ashtu nuk ka qenë e rregulluar ligjërisht, kjo vlen për periudhën nga data 14.02.2022 deri në kohën kur ka filluar të aplikohet Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe Rregullorja (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, ndërsa për pjesë nga hyrja në fuqi e tyre, Kolegji i Këshillit, konstaton se është dashur të plotësohen disa kushte ligjore për aplikimin e shtesës së kërkuar nga ankuesi për funksionet e emëruara me vendimin 01. Nr. 308/2023 të datës 16.10.2023 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe vendimin Nr. 01-190/2024 të datës 01.07.2024 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave, e cila sipas referimeve ligjore është përjashtuar kompensimi.

Referuar provave materiale të lëndës, vërtetohet se ankuesi është i emëruar në menaxhim të kontratave dhe komision të vlerësimit të ofertave të lidhura përmes procedurave të prokurimit, me vendimin 01.Nr. 318/2022 të datës 14.02.2022 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherit kontratës, vendimin 01. Nr. 308/2023 të datës 16.10.2023 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherit kontratës, vendimin Nr. 01-190/2024 të datës 01.07.2024 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave, mirëpo ky fakt sipas dispozitave ligjore në fuqi të cekura më lartë nuk i jep të drejtë ankuesit për kompensim për punë me vëllim të shtuar dhe gjithashtu nuk mund të kategorizohet si e drejtë për kompensim për funksion shtesë,

sepse siç e përcakton neni 38 i Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 5 i Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, pika 5 e Qarkores rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, funksionet të cilat i ushtron ankuesi, si menaxher kontrate dhe i emëruar anëtarë i komisionit të vlerësimit të ofertave nuk përbëjnë bazë për kompensim, përkundrazi kompensimi për ushtrimin e këtyre funksioneve është përjashtuar sipas kuadrit ligjor të cekur më lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.550/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore Gashi BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses L.B;*
- *Kryetarit të Komunës së Ferizajt;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të K. Ferizaj*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*